VENDIM
Nr.270, datë 21.4.2010

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E INTEGRIMIT, PËR PAGESËN E FONDEVE TË MBAJTURA NGA KOMISIONI EUROPIAN PËR DISA PROJEKTE, TË FINANCUARA NGA PROGRAMI CARDS, ME PËRFITUES MINISTRINË E INTEGRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Integrimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Integrimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t'i shtohet fondi 25 250 000 (njëzet e pesë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për pagesën e fondeve të mbajtura nga Komisioni Europian për disa projekte, të financuara nga programi CARDS, me përfitues Ministrinë e Integrimit.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3.Ngarkohen Ministria e Integrimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha